

FINANCA

BULETINI MUJOR | TETOR 2024



PROJEKTBUXHETI 2025 PREZANTOHET NË KONFERENCËN E KRYETARËVE, MBËSHETJE E RITJES SË QËNDRUESHME EKONOMIKE DHE KONSOLIDIMIT FISKAL

Ministri i Financave prezantoi në Konferencën e Kryetarëve projektligjin "Për buxhetin e vitit 2025". Në fjalën e tij, Ministri Malaj u shpreh se projektbuxheti synon të mbështesë rritjen e qëndrueshme të ekonomisë dhe të vijojë konsolidimin fiskal, ndërsa një vëmendje e veçantë i është kushtuar financimit të Planit të Rritjes së Bashkimit Europian për Ballkanin Perëndimor. Ministri tha se projektbuxheti 2025

tejkalon shifrën 8 miliardë euro shpenzime publike të planifikuara dhe projektin vijimin e uljes së borxhit publik, duke u fokusuar tërësisht në mirëadministrimin fiskal pa prezantuar masa të reja fiskale. Sipas z. Malaj, buxheti i vitit të ardhshëm do të zbatohet në përputhje të plotë me objektivat kryesorë të politikës fiskale, duke synuar kufizimin e deficitit të përgjithshëm buxhetor në 2.6% të PBB-së dhe ruajtjen e një bilanci primar pozitiv, me qëllimin vijimin e uljes së raportit të borxhit publik ndaj PBB-së, sipas pritshmërive aktuale në nivelin 56% të PBB. Ministri theksoi se për vitin 2025 parashikohet që ekonomia të rritet me rreth 3.9%, ashtu si edhe në periudhën afatmesme.

LEXO MË SHUMË

MINISTRI PETRIT MALAJ MERR PJESË NË TAKIMET VJETORE TË FMN DHE GRUPIT TË BB

Ministri i Financave, Petrit Malaj, mori pjesë në Takimet Vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Grupit të Bankës Botërore, që u zhvilluan në datat 21-26 Tetor 2024, në Uashington, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shqipëria u përfaqësua në këto takime nga një delegacion i nivelit të lartë me përfaqësues nga

Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë. Ministri Malaj zhvilloi disa takime të rëndësishme me drejtues të lartë të institucioneve financiare ndërkombëtare, me të cilët diskutoi zhvillimet më të fundit ekonomike në vendin tonë, pritshmërive për të ardhmen dhe bashkëpunimit me FMN dhe BB. Në këto takime, Ministri Malaj bëri një prezantim të treguesve kryesorë makroekonomike dhe nënvizoi faktin se ekonomia shqiptare ka vijuar të rritet pozitivisht gjatë vitit 2024.

Nga ana e përfaqësuesve të FMN dhe BB u vlerësua progresi ekonomik i vendit tonë dhe ulja e nivelit të borxhit publik, ndërsa u shpreh angazhimi për vijimin e mbështetjes dhe bashkëpunimit.

LEXO MË SHUMË



PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS PARAPRAKE TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN 9-MUJORE 2024

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për periudhën Janar-Shtator 2024 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale, për periudhën 9-mujore, arritën në rreth 528.4 miliardë lekë ose 99.6% e planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, u mblodhën rreth 51 miliardë lekë më shumë ose 10.7% më shumë se 9-mujori i vitit 2023. Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën 9 muajore të vitit 2024, arritën në rreth 459 miliardë lekë me një realizim në masën 95.1 përqind të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 ky zë ka rezultuar 7.8 përqind më i lartë ose rreth 33 miliardë lekë më shumë. Shpenzimet kapitale, për periudhën 9-mujore të vitit 2024, rezultuan në rreth 47.7 miliardë lekë, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ky zë ka rezultuar 2.8% më i lartë ose rreth 1.3 milionë lekë më shumë.

LEXO MË SHUMË

MOODY'S PËRMIRËSON VLERËSIMIN E SHQIPËRISË, DUKE E NDRYSHUAR ATË NË "BA3" ME PERSPEKTIVË TË "QËNDRUESHME"



Agjencia ndërkombëtare e vlerësimit të kreditit Moody's ka rritur vlerësimin e Shqipërisë në "Ba3 - e qëndrueshme" nga "B1 - pozitive", duke theksuar përmirësimin e profilit të kreditit të vendit si rezultat i forcimit të

vazhdueshmë të kapaciteteve ekonomike dhe fiskale. Vlerësimi i Moody's thekson përmirësimin e pozicionit fiskal të vendit, të nxitur nga rritja e qëndrueshme ekonomike e kombinuar me një ulje të konsiderueshme të deficitit fiskal. Raporti i borxhit publik ndaj PBB-së është ulur ndjeshëm që nga niveli më i lartë i regjistruar në vitin 2021 dhe parashikon një ulje të mëtejshme graduale në periudhën afatmesme, të mbështetur nga zbatimi i reformave fiskale. Rishikimi i vlerësimit të Moody's u përshëndet edhe nga Ministri i Financave, sipas të cilit, ky vlerësim reflekton të gjitha përpjekjet për të siguruar një rritje të qëndrueshme të ekonomisë, forcimin e mëtejshëm të financave publike, si dhe një efikasitet më të lartë në zbatimin e reformave strukturore.

LEXO MË SHUMË

MINISTRI MALAJ: PO PUNOJMË PËR NJË SKEMË PENSIONESH TË QËNDRUESHME QË GARANTON PENSIONE MË TË LARTA



Ministri i Financave, Petrit Malaj, mori pjesë në një takim të zhvilluar me pensionistët, së bashku me Kryeministrin Edi Rama dhe Ministrin e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, z. Blendi

Gonxhja. Në fjalën e tij, Ministri Malaj tha po punohet për adresimin e çështjes së pensioneëve, si në terma afatshkurtër, ashtu edhe në terma afatgjatë. Në terma afatshkurtër, sipas Ministrin, po shqyrtohet mundësia e rritjes së bonusit të fundvitit, ndërsa në terma afatgjatë po punohet për krijimin e një skeme pensionesh të qëndrueshme dhe që do të garantojë në vazhdimësi pensione më të larta. Nga ana tjetër, Ministri Malaj sqaroi se indeksimi i fundit i pensioneëve në masën 4.1% nuk ka të bëjë me reformën që qeveria synon të ndërmarrë në këtë fushë, por është një detyrim ligjor që lidhet me rritjen e vazhdueshme të çmimeve.

LEXO MË SHUMË



STRATEGJIA AFATMESME E TË ARDHURAVE 2024-2027, TAKIM KONSULTUES ME DHOMAT DHE SHOQATAT E BIZNESIT

Nën drejtimin e Ministrin të Financave u zhvillua një takim me përfaqësues të dhomave të tregtisë dhe shoqatave të biznesit, me qëllim konsultimin e draft Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave

2024-2027. Ministri Malaj theksoi rëndësinë e konsultimit publik të draft strategjisë me të gjitha grupet e interesit, përfshirë atë me dhomat dhe shoqata e tregtisë, në mënyrë që të finalizohet një dokument sa më gjithëpërfshirës dhe të garantohet zbatimi me efikasitet. Ministri informoi pjesëmarrësit se draft strategjia përbëhet nga tre shtylla kryesore: rishikimi i politikave tatimore; miradministrimi tatimor; dhe miradministrimi doganor.

LEXO MË SHUMË

SHQIPËRI-BE, ZHVILLOHET MBLLEDHJA E 15-TË E NËNKOMITETIT SHQIPËRI-BE "PËR TREGTINË, INDUSTRIJË, DOGANAT DHE TATIMET"

Nënkomiteti "Për tregtinë, industrinë, doganat dhe tatimet" mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian zhvilloi mbledhjen e 15-të, më 23-24 Tetor, në Bruksel.

Nënkomiteti mbulon raportimin një vjeçar të palës shqiptare kryesisht për Kapitullin 16 "Tatimet", Kapitullin 29 "Bashkimi Doganor", Kapitullin 1 "Lëvizja e lirë e mallrave"; dhe Kapitullin 20 "Ndërmarrjet dhe politikat industriale". Palas shqiptare informoi mbi disa nga zhvillimet më të fundit në Shqipëri në fushën e tregtisë, tatimeve dhe doganave. Gjatë diskutimeve u vlerësuan një sërë masash të ndërmarrja nga qeveria shqiptare, si miratimi i draft Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave 2024-2027; masat e ndërmarrja në kuadër të Planit të Rritjes; implementimi i Strategjisë së Biznesit të Administratës Doganore Shqiptare për vitet 2023-2027, etj.



LEXO MË SHUMË



MIRËQEVERISJA DHE PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE, ZHVILLOHET TAKIMI MBI VLERËSIMIN PEFA NË NIVEL VENDOR

Nën drejtimin e Drejtoreshës së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave, Mimoza Dhëmbi, dhe Zv. Ambasadorit të Zvicrës në Tiranë, z. Philipp Arnold, u zhvillua takimi për Shpenzimet Publike dhe Përgjegjësinë Financiare (PEFA) në nivel vendor. Takimi u organizua nga ekspertët që do të bëjnë vlerësimin

PEFA në nivel vendor, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bashkive të përzgjedhura për këtë vlerësim: Tiranë, Fier, Kuçovë, Berat dhe Tropojë. Pjesëmarrësit u informuan mbi metodologjinë dhe indikatorët që do të përdoren në këtë vlerësim, qëllimi kryesor i të cilit është të sigurohet një pasqyrë e saktë mbi pikat e forta dhe të dobëta të menaxhimit financiar publik në pesë bashki të përzgjedhura.

LEXO MË SHUMË

TAKIMI I 18-TË I KOMITETIT DREJTUES TË MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE

Nën drejtimin e Ministrin të Financave u zhvillua takimi i 18-të i Komitetit Drejtues të Menaxhimit të Financave Publike, me qëllim diskutimin dhe miratimin e draft Raportit Vjetor të Monitorimit për vitin 2023 të Strategjisë së Monitorimit të Financave Publike 2023-2030. Ministri Malaj theksoi rëndësinë e menaxhimit efektiv të financave publike sa i përket zhvillimit të qëndrueshëm dhe shpërndarjes së drejtë të burimeve. Raporti i monitorimit për vitin 2023 pasqyron angazhimin për qeverisje efektive të financave publike dhe thekson progresin në zbatimin e planit të veprimit, me 80% të progresit në nivel tregues performance dhe 82.61% të progresit në nivel aktiviteti. Referuar progresit, Ministria e Financave ka bërë përparime të rëndësishme sa i përket: programimit makroekonomik; monitorimit të risqeve fiskale dhe planifikimit të integruar të buxhetit; mobilizimit të të ardhurave; praktikave të kontabilitetit; kontrolleve të brendshme financiare publike dhe mbikëqyrjes së jashtme.



LEXO MË SHUMË